



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.865/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Denis Halilaj nga Subjekti Politik IRDK, me seli në Prishtinë, dega ne Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.865/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Denis Halilaj nga Subjekti Politik IRDK, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakovës

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për Kuvendin Komunal Denis Halilaj nga Subjekti Politik IRDK, me seli në Prishtinë, dega ne Gjakov, në të cilin pretendon se sipas rezultatit final te KQZ-se si kandidat per kuvend komunal Denis Halitaj me numër 12 ka marr vetëm 10 vota, duke besuar fuqishëm qe si kandidat ka marr shume me shume vota duke u nisur nga aspekti familjar dhe me gjere te cilët pohojne se e kane votuar ne ato vendvotime per te cilat kërkon rinumërim :0214C/01R, 0214C/03R, 0214C/04R, 0223C/01R, 0223C/02R.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për Kuvend Komunal Denis Hajra nga Subjektit IRDK, me seli në Gjakov, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet: 0214C/01R, 0214C/03R, 0214C/04R, 0223C/01R, 0223C/02R.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.865/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të